

V E N D I M
Nr. 289, datë 27.6.2002

**PËR RIORGANIZIMIN E POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT NË
OBJEKTET ME RËNDËSI EKONOMIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1, 2, 5 e 6 të nenit 4 dhe të nenit 41 të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në objektet me rëndësi ekonomike: Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza" sh.a., Portin Detar Durrës sh.a., Kombinatin e Përpunimit të Thellë të Naftës (KPTHN) "Armo" Ballsh sh.a. të strukturorohen stacionet e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

Limiti organik, teknika e pajisjet e tyre të jenë jo më të vogla se përcaktimet e lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Limitet organike të stacioneve të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin të këtyre objekteve, të cilat janë strukturë e Drejtorisë së Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, të kalojnë limit organik, përkatësisht, të Albtransport Rinas Tiranë sh.a. dhe të Portit Detar Durrës sh.a., në varësi të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, të KPTHN "Armo" Ballsh sh.a., në varësi të Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës.

3. Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, prefektët e qarqeve Tiranë, Durrës e Fier, të bëjnë kalimin kapital të mjeteve themelore, si teknikën e pajisjet, inventarin e stacioneve të PMNZSH-së, të vendosura për funksionimin e këtyre objekteve.

4. Shpenzimet financiare për funksionimin e stacioneve të MNZSH-së në Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza" sh.a., Portin Detar Durrës sh.a., dhe KPTHN, "Armo", Ballsh sh.a., ku përfshihen shpenzimet për investime, shpenzimet administrative, fondi i pagave, sigurimet shoqërore e shëndetësore, pajisja materialo-teknike e stacioneve sipas normave teknike, të përballohen nga të ardhurat që realizojnë këto subjekte, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Drejtoritë e ndërmarrjeve Albtransport Rinas, Tiranë sh.a., Porti Detar Durrës, sh.a., KPTHN "Armo", Ballsh, sh.a., të plainifikojë fondet për investime në infrastrukturën e këtyre stacioneve dhe për pajisjen me teknikë, në përputhje me normat teknike dhe ato ndërkombëtare të pranuar.

6. Emërtimi, titullimi, transferimi dhe lirimi nga detyra e oficerit në organikë të stacionit të PMNZSH-së në këto objekte bëhen nga Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.

7. Pajisja me personel shërbimi e këtyre stacioneve të bëhet nga prefekti i qarkut, me propozimin e drejtorive përkatëse të këtyre objekteve dhe shefit të stacionit të PMNZSH-së së objektit, duke zbatuar kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 8766, datë 5.4.2001 dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

8. Organizimi, drejtimi dhe formimi profesional i personelit të këtyre stacioneve të bëhen nga shefi i PMNZSH-së së objektit dhe të kontrollohen nga Drejtoria e PMNZSH-së.

9. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit të nxjerrin urdhrat administrative të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

10. Prefekti i qarkut të sigurojë funksionimin e stacioneve të PMNZSH-së në këto objekte, deri në përfundimin e procedurave të kalimit dhe riorganizimit.

11. Detyrat e përcaktuara në këtë vendim të përfundojnë brenda tremujorit të tretë të vitit 2002.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

LIDHJA 1

STACIONI I PMNZSH-SË TË AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË RINASIT

Personeli:

1. Shefi i PMNZSh-së së objektit	Oficer	1 (një)
2. Komandant stacioni	n/oficer 1 (një)	
3. Komandant turni	Polic	4 (katër)
4. Shoferë zjarrfikës	Polic	12 (dymbëdhjetë)
5. Policë zjarrfikës	Polic	16 (gjashtëmbëdhjetë)
Totali	Oficer	1 (një)
	Policë	33 (tridhjetë e tre)

Teknika zjarrfikëse:

1. Autozjarrfikëse	2 (dy)
2. Autozjarrfikëse shpëtimi	1 (një)
3. Autozjarrfikëse e ndihmës së shpejtë	1 (një)
4. Motopompa portative	2 (dy)
5. Radio ndërlidhjeje	5 (pesë)

LIDHJA 1

STACIONI I PMNZSH-SË TË PORTIT DETAR DURRËS

Personeli:

1. Shefi i PMNZSH-së së objektit	Oficer	1 (një)
2. Komandant stacioni	Polic	1 (një)
3. Komandant turni	Polic	4 (katër)
4. Shoferë zjarrfikës	Polic	12 (dymbëdhjetë)
5. Policë zjarrfikës	Polic	16 (gjashtëmbëdhjetë)
Totali	Oficer	1 (një)
	Policë	33 (tridhjetë e tre)

Teknika zjarrfikëse:

1. Autozjarrfikëse	3 (tre)
2. Autozjarrfikëse shpëtimi	1 (një)
3. Autozjarrfikëse e ndihmës së shpejtë	1 (një)
4. Motopompa portative	2 (dy)
5. Radio ndërlidhjeje	5 (pesë)

LIDHJA NR. 1

STACIONI I PMNZSH-SË I KOMBINATIT TË PËRPUNIMIT TË THELLË TË NAFTËS BALLSH

Personeli:

1. Shefi i PMNZSh-së së objektit	Oficer 1 (një)
----------------------------------	----------------

2. Komandant stacioni	Polic 1 (një)
3. Komandante turni	Polic 4 (katër)
4. Shoferë zjarrfikës	Polic 12 (Dymbëdhjetë)
5. Policë zjarrfikës	Polic 16 (Gjashtëmbëdhjetë)
Totali	Oficerë 1 (një) Policë 33 (tridhjetë e tre)

Teknika zjarrfikëse:

1. Autozjarrfikëse	3 (tre)
2. Autozjarrfikëse shpëtimi	1 (një)
3. Autozjarrfikëse e ndihmës së shpejtë	1 (një)
4. Motopompa portative	2 (dy)
5. Radio ndërlidhje	5 (pesë)